



Datë: 05.10.2022
01 Nr.06-350/02-4729/22

Në bazë të nenit 10, paragrafi 1 dhe 1.1 të nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme, Ligji Nr.03/ L-139 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme, Ligji Nr.03/L205 dhe nenit 13,82 dhe 109 të Ligjit për procedurën administrative Nr.02/L-28 si dhe shqyrtimit të komenteve, deklaratave dhe mendimeve të shprehura në dëgjimin publik të datës 05.02.2021, brenda afatit ligjor merr këtë:

VENDIM PRELIMINAR

I. APROVOHET shpronësimi për interes publik i pronave të palauajtshme; parcelat kadastrale nr.01306-2, me kulturë kulllosë e klasës 4 , me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër e cila evidentohet në emër të Mustafë (Isuf) Lama dhe 01306-8 me kulturë kulllosë e klasës 4 , me sipërfaqe prej 600 m², Z.K Kačanik i Vjetër e cila evidentohet në emër të Radojka (Zora) Gjorgjeviq.

II. VËRTETOHET se është i domosdoshëm dhe i ligjshëm shpronësimi i parcelave kadastrale të lartëcekura, për nevoja të hapsirave shkollë të shkollës fillore "Qamil Ilazi" në Kačanik të Vjetër.

III. Vendimin preliminar pas miratimit, organi shpronësues u dërgohet pronarit-zotëruesit të pronës dhe personave tjerë që pretendojnë se ju takon e drejta në pronën që do të shpronësohet. Vendimi preliminar hyn në fuqi ditën e shpalljes, në bazë të nenit 4 dhe 43 të Ligjit për shpronësim.

A r s y e t i m

Duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi si dhe duke e marr parasysh Interesin Publik, ku Shkolla Fillore "Qamil Ilazi" e cila është funksionale dhe hapsirat e larëshënuara i shfrytëzon për oborr dhe fusha sportive, të cilat hapsira janë të rrethuara së bashku me shkollën. Këto patundëshmeri janë me karakter të interesit publik, prandaj Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, në mbledhjen e mbajtur më datë 28.02.2022 ka marrë vendimin 01 Nr.06-350/02-4729/22 për Shpalljen e Interesit Publik për parcelat kadastrale të lartëshënuara.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur ka të drejtë ankese brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, subjekti kërkues apo cildo person i cili është pronarë apo zotërues i interesit, në pronën e paluajtëshme të prekur nga ky vendim.

Vendimi i dërgohet:

1. Paraqitësit të kërkesës,
2. Poseduesit juridik-zotëruesit të interesit të pronës,
3. Gazetës zyrtare të Kosovës dhe një gazete ditore me tirazh më të madh.

